



AKTUALE



GJYKATA KUSHTETUESE SHPALL TË PAPANUESHME KËRKESËN E HARADINAJT F. 4

MBI 25 VJET BURGIM PËR PERSONAT QË PLANIFIKUAN SULM NDAJ KFOR-it F. 5

1 MILION E 972 MIJË E 466 QYTETARË ME TË DREJTË VOTE NË ZGJEDHJET E 6 TETORIT F. 3

EKONOMI



BE-ja DHE FIQ-i NDAJNË 8 000 EURO PËR 20 NDËRMARRËS TË RINJ F. 8

PËR GJASHTË MUAJ 20 KOMPANI GJERMANE KANË HAPUR DEGËT E VETA NË KOSOVË F. 9

SPORT

'PROFA' KA SYNIME TË MËDHA ME PRISHTINËN F. 13

FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ | FAQE 4-5



Kandidatët për kryeministër të përmbahen nga manipulimet

Politologu Belul Beqaj u ka bërë thirrje kandidatëve për kryeministër që të përmbahen në premtimet parazgjedhore. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se

premtimet joreale të subjekteve politike e bastardojnë fushatën. Ai ka vlerësuar se mashtrimet gjatë fushatës mund t'u kthehen bumerang partive. Sipas Beqajt, kandidatët për

kryeministër dhe deputetët duhet të përmbahen nga manipulimet dhe lajthitjet. Ai ka shfaqur frikën e tij se edhe kjo fushatë do të përfshihet nga premtimet populiste

SENATORËT AMERIKANË CHRIS MURPHY DHE RON JOHNSON KANË VIZITUAR REPUBLIKËN E KOSOVËS, ME Ç'RAST JANË PRITUR NGA LIDERËT SHTETËTORË DHE PARTIAKË

Senatorët amerikanë: Kërkohe sakrificë për arritjen e marrëveshjes Kosovë - Serbi

Presim që dialogu të jetë i frytshëm dhe shpresojmë se palët do ta kuptojnë se kërkohet sakrificë për arritjen e marrëveshjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kështu kanë deklaruar të mërkurën në Prishtinë senatorët amerikanë Chris Murphy dhe Ron Johnson. Ata kanë thënë se vizita e tyre në Kosovë është një rikonfirmim i mbështetjes së ShBA-së ndaj procesit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kostelancik: ShBA-ja do ta mbështesë vetingun në Shqipëri

TIRANË, 4 SHTATOR - Drejtori i ri për Evropën Qendrore dhe Jugore në Departamentin Amerikan, Dave Kostelancik, mbërriti në Tiranë në kulmin e krizës politike. I shoqëruar edhe nga e ngarkuara me punë e Ambasadës së ShBA-së në Tiranë, Leyla Moses-Ones, zyrtari i lartë amerikan i nisi takimet me kryeparlamentarët Gramoz Ruçi në kryesinë e Kuvendit, aty ku nisi edhe kriza shqiptare me djegien e mandatëve të PD-LSI. Në njoftimin e shpërndarë nga zyra e shtypit e Kuvendit, thuhet se zyrtari i DASH-it vuri në dukje nevojën për kryerjen e reformës zgjedhore duke rekomanduar se është përgjegjësi e qeverisë që dora e

shtrirë për opozitën duhet ta mundësojë tërheqjen e saj në realizimin e kësaj reforme. Kryerja e kësaj reforme brenda vitit, sipas zyrtarit amerikan, do të mundësojë edhe një presidencë shqiptare të suksesshme të OSBE-së në vitin 2020. Reforma në drejtësi ishte një tjetër temë e prekur në takim, ku Kostelancik nënvizoi se vetingu mbështetet fort nga ShBA-ja. Në drekë, drejtori i ri për Evropën Qendrore dhe Jugore në Departamentin Amerikan zhvilloi takime të ndara me drejtuesen e LSI-së, Monika Kryemadhi dhe kryetarin e Partisë Demokratike. Lulzim Basha në disa rreshta që shkroi në "Twitter" zbuloi edhe

detaje nga biseda me zyrtarin amerikan. Dhënia fund e pandëshkueshmërisë së politikanëve, korrupsionit dhe kapjes së shtetit si dhe rikthimi i sundimit të ligjit, dhe forcimi i partneritetit strategjik të Shqipërisë me ShBA-në ishin, sipas Bashës, fokusi i diskutimit të hapur dhe konstruktiv me drejtorin e Zyrës së Evropës Jugore dhe Qendrore në Departamentin e Shtetit.

Ndërsa kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, i shprehu Kostelancik vlerësimet më të larta për bashkëpunimin strategjik me ShBA-në dhe e falënderoi për mbështetjen ndër vite që ShBA-ja ka dhënë për progresin



demokratik të Shqipërisë, si dhe për mbështetjen e veçantë për anëtarësimin në NATO dhe rrugëtimin drejt BE-së.

Kryeministrin Johnson po e përçjell fati i Theresa May

Parlamenti britanik, ashtu siç kishte vepruar edhe me ish-kryeministren Theresa May, nuk po lejon që për procesin e Brexit-it të vendosë qeveria dhe po kundërshton çdo iniciativë që do t'i lejonte kryeministrat të vepronë sipas planeve të tyre



LONDËR, 4 SHTATOR - Kryeministrin britanik Boris Johnson po e përçjell fati i paraardhëses së tij, Theresa May. Parlamenti britanik nuk po lejon që për procesin e Brexit-it të vendosë qeveria dhe po kundërshton çdo iniciativë që do t'i lejonte kryeministrat të vepronë sipas planeve të tyre. Njëjtë kishte vepruar edhe me ish-kryeministren Theresa May, së cilës ia kundërshtonte çdo nismë qeveritare për Brexit-in. I tillë ishte edhe votimi i së martës, kur ligjëvendësit me shumicë miratuan marrjen nën kontroll të rendit të ditës, masë kjo që do t'i lejojë ata të sjellin një projektligj për ta kërkuar shtyrjen e Brexit-it. Brexit-i duhet të ndodhë më 31 tetor, dhe kryeministri Johnson, që nga marrja e detyrës, ka prem-

tuar se nuk do të lëvizë nga ky afat. Ai iu tha ligjëvendësve se do të thërrasë zgjedhje të përgjithshme në rast se detyrohet të kërkojë një zgjatje të afatit për daljen e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian. Johnson e paraqiti në Parlament një mocion për zgjedhje të parakohshme, mirëpo pa e specifikuar datën e mbajtjes së tyre. Sipas një projektligji të përgatitur nga opozita dhe deputetët e pakënaqur të Partisë Konservatore në pushtet, kryeministri do të duhej të kërkonte shtyrjen e Brexit-it deri më 31 janar të vitit të ardhshëm. Opozita ka thënë se para se të votojnë për zgjedhje të parakohshme duhet të miratohet një projektligj që përjashton një Brexit pa marrëveshje. Por,

Johnsoni tha se projektligji do të sillte "më shumë zhurmë, më shumë vonesë dhe konfuzion". Ai theksoi se nuk kishte zgjidhje tjetër përveçse t'i vazhdonte përpjekjet për t'i thirrur zgjedhjet e parakohshme, duke shtuar se populli i këtij vendi do të duhet të zgjedhë.

Më herët, kryeministri Johnson e humbi shumicën në Parlament pasi deputeti konservator, Philip Lee, zuri vendin e tij në ulëset e opozitës. "Qeveria konservatore po e vazhdon në mënyrë agresive procesin e Brexit-it me pasojë të dëmshme. Ai po kërcënon padrejtësisht integritetin e Britanisë

së Madhe", tha Lee pasi u bashkua me radhët e opozitës në parlament. Marrëveshja e negociuar nga BE-ja dhe ish-kryeministrja britanike Theresa May është rrëzuar nga Parlamenti britanik tri herë radhazi. Ajo më pas dha dorëheqje nga pozita duke u pasuar nga Boris Johnsoni.

Osmani: Ahmeti i duhet edhe më tej partisë

SHKUP, 4 SHTATOR - Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) në mbledhjen e së mërkurës ka diskutuar për situatën aktuale politike në vend si dhe për organizimin e brendshëm të partisë për mbajtjen e kongresit të radhës. Në pjesën e parë të mbledhjes, sipas zëdhënësit Bujar Osmani, do të diskutohet mbi vetingun kryesisht, si propozim i BDI-së, por edhe për çështjet e

euro-integrimeve të vendit dhe rezikimin e tyre nga situata e fundit e krijuara në shtet. Osmani tha se më e rëndësishme do të jetë pjesa e dytë, sepse kongresi i radhës është tejet i rëndësishëm meqë do ta përcaktojë orientimin partiak për dy dekadat e ardhshme. I pyetur nëse edhe më tej partinë do ta drejtojë Ali Ahmeti pasi shteti të bëhet pjesë e NATO-s,



Osmani tha se këto çështje vendosen nga njerëzit dhe se Ahmeti i duhet edhe më tej par-

tisë. Osmani ka komentuar edhe rikthimin e mundshëm të ish-sekretarit të përgjithshëm Hazbi Lika në kongresin e radhës, me ç'rast Osmani ka thënë se në kongres secili ka të drejtë të marrë pjesë dhe të kandidojë për organet e caktuara të partisë. "Fillojmë me këto mbledhje, ku në pjesën e parë do të diskutohet për zhvillimet e fun-

dit politike, me theks në temat kryesore të cilat ne i kemi si përcaktime strategjike. Në fokus do të jetë vetingu si koncept që ne e kemi propozuar, kurse pjesa e dytë do të jetë organizimi i brendshëm partiak ku do të diskutohen përgatitjet për kongresin e rregullt të BDI-së, ku do të përcaktohen parimet e BDI-së në 20 vjetët e ardhshëm", tha Osmani.

Senatorët amerikanë Chris Murphy dhe Ron Johnson kanë vizituar Republikën e Kosovës me ç'rast janë pritur nga liderët shtetërorë dhe partiakë

Senatorët amerikanë: Kërkohe sakrificë për arritjen e marrëveshjes Kosovë - Serbi



së ardhmes. Pra, jemi këtu së pari t'i mbështesim qytetarët e rajonit, qytetarët e Kosovës dhe qytetarët e Serbisë. Ne duam që t'i shohim ata të kenë sukses", ka deklaruar senatori Johnson.

Senatorët e vulosën qëndrimin amerikan për pritshmëritë në kontestin Kosovë - Serbi

Për vizitën dhe mesazhin e senatorëve amerikanë ka folur të mërkurën profesori i qeverisjes amerikane, Ilir Ibrahim. Ai ka thënë se senatorët amerikanë e kanë vulosur qëndrimin amerikan për pritshmëritë e administratës amerikane në kontestin Kosovë - Serbi. Ibrahim ka thënë se përkrahja amerikane ekziston nga dy krahët politikë, republikan dhe demokratik. Sipas tij, është e turpshme që klasa politike e Kosovës nuk arrin ta ndërtojë një konsensus për të dëshmuar se është partner i denjë ndaj një miku të dëshmuar. "Senatorët amerikanë sot e vulosën qëndrimin amerikan për pritshmëritë e administratës amerikane në kontestin Kosovë - Serbi. Zërat injorantë, shpesh edhe dashakeqës, se gjoja 'qarqe të caktuara brenda administratës Trump e paskan një plan konspirativ', sot u demaskuan. Përkrahja amerikane, fatmirësisht, ka ekzistuar në të dy krahët politikë. Këtë e dëgjuam edhe sot nga dy senatorët të dy partive të ndryshme. Nëse ka pasur dhe ka një konsensus dhe bashkëdyzim në administratën amerikane për Kosovën, është turp, bile kam frikë edhe më shumë se turp që klasa politike kosovare nuk arrin ta ndërtojë një konsensus për të dëshmuar se është partnere e denjë ndaj një miku të dëshmuar", ka shkruar Ibrahim në llogarinë e vet në "Facebook".

Presim që dialogu të jetë i frytshëm dhe shpresojmë se palët do ta kuptojnë se kërkohe sakrificë për arritjen e marrëveshjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kështu kanë deklaruar të mërkurën në Prishtinë senatorët amerikanë Chris Murphy dhe Ron Johnson. Ata kanë thënë se vizita e tyre në Kosovë është një rikonfirmim i mbështetjes së ShBA-së ndaj procesit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Senatorët amerikanë, republikani Chris Murphy dhe demokrati Ron Johnson, kanë vizituar të mërkurën Republikën e Kosovës, me ç'rast janë pritur nga liderët shtetërorë dhe partiakë. Në një konferencë të përbashkët për medie senatorët amerikanë kanë bërë me dije se tema kyçe për të cilën është biseduar ka qenë procesi i normalizimit të marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë.

Senatori republikan Chris Murphy ka thënë se palët duhet

ta kuptojnë se kërkohe sakrificë për arritjen e marrëveshjes përfundimtare ndërmjet dy vendeve. "Ne presim që ky dialog të jetë kuptimplotë dhe i frytshëm dhe shpresojmë që të dyja palët do ta kuptojnë se kërkohe sakrificë për të qenë e mundur që të normalizohen raportet mes këtyre dy kombeve", ka deklaruar Murphy.

Pavarësisht prej vështirësive, ai ka deklaruar se arritja e kësaj marrëveshje do të kishte ndikim të madh pozitiv edhe në aspektin ekonomik për të dy vendet. "Ne shohim një të ardhme për Kosovën që ekziston me miqtë tanë në komunitetin evropian

dhe të gjithë bizneset amerikane dhe transatlantike që mund të jenë partnerë në suksesin ekonomik të Kosovës. Por, janë dy gjëra të nevojshme për ringjalljen ekonomike. E para është reforma e brendshme, përkushtimi për rendin dhe ligjin, përkushtimi për reformën në sistemin e edukimit, po ashtu përkushtimi për dialogun me Serbinë që do të përfshijë zgjidhje të vështira, këtu dhe në Beograd", ka deklaruar senatori Murphy, duke shtuar se mesazhet e njëjta do t'i përcjellin edhe gjatë vizitës në Beograd. "Ne do të shkojmë edhe në Beograd dhe do t'i themi gjërat e

nëjta që i thamë këtu", është shprehur ai.

Kurse senatori demokrat Ron Johnson ka thënë se vizita e tyre në Kosovë është një rikonfirmim i mbështetjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) ndaj procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka vlerësuar se arritja e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë është çelësi që hap potencialin e së ardhmes. "Në veçanti ne kemi qenë të përfshirë, unë kam qenë, njëjtë dhe senatori Murphy në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, që të vijmë deri te një marrëveshje që është çelësi që hap potencialin e

1 milion e 972 mijë e 466 qytetarë me të drejtë vote në zgjedhjet e 6 tetorit

Prishtinë, 4 shtator - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në mbledhjen e së mërkurës ka bërë me dije se në zgjedhjet e 6 tetorit, sipas listës preliminare, të drejtë vote kanë 1 milion e 972 mijë e 466 votues. Po në këtë mbledhje është treguar se 33 791 emra të qytetarëve janë larguar nga lista votuese, të cilët kanë vdekur ose kanë hequr

dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës.

Kryeshefi ekzekutiv i sekretariatit të KQZ-së, Enis Halimi, ka thënë se nga 30 gushti kur edhe ka nisur aplikimi për regjistrim për votuesit jashtë vendit deri tani kanë pranuar 4 977 aplikacione. "Sekretariati ka filluar me aktivitetet e veta në lidhje me procesin zgjedhor të 6 tetorit.

Deri më 4 shtator përmes e-mailit ne kemi pranuar mbi 4 000 aplikacione të cilët janë në procesin e vlerësimit", ka thënë Halimi.

Kurse drejtori ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim të Partive Politike, Yll Buleshku, ka thënë se deri më tash nuk ka kandiduar për certifikim asnjë subjekt politik dhe as ndonjë kandidat i pavarur.



Flet për "Epokën e re", Belul Beqaj

Kandidatët për kryeministër të



Politologu Belul Beqaj u ka bërë thirrje kandidatëve për kryeministër që të përmbahen në premtimet parazgjedhore. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se premtimet joreale të subjekteve politike e bastardojnë fushatën. Ai ka vlerësuar se mashtrimet gjatë fushatës mund t'u kthehen bumerang partive. Sipas Beqajt, kandidatët për kryeministër dhe deputetët duhet të përmbahen nga manipulimet dhe lajthitjet. Ai ka shfaqur drojën e tij se edhe kjo fushatë do të përfshihet nga premtimet populiste

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Politologu Belul Beqaj i ka ftuar kandidatët për kryeministër që të jenë të kujdesshëm në premtimet para dhe gjatë fushatës zgjedhore. Ai ka thënë se kandidatët për kryeministër dhe deputetët duhet të përmbahen nga manipulimet dhe lajthitjet. Në këtë intervistë dhënë gazetës

"Epoka e re", ai ka vlerësuar se premtimet joreale të subjekteve politike e bastardojnë fushatën. "Pretimet joreale e bastardojnë fushatën. Prandaj, kandidatët për kryeministër dhe deputetët duhet të përmbahen nga manipulimet dhe lajthitjet. Ata mund të mashtrojnë gjatë fushatës votuesit, por do ta humbin besimin pas zgjedhjeve. Subjektet mashtrojnë njëherë, dy herë..., por besoj se nuk munden vazhdimisht", ka

Gjykata Kushtetuese shpall të papranueshme kërkesën e Haradinajt

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Gjykata Kushtetuese e ka shpallur të papranueshëm interpretimin e aktit të dorëheqjes së kryeministrit të Republikës së Kosovës, përcaktimin e kompetencave dhe funksionimin e qeverisë pas dhënies

së dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj. "Kërkesa bazohej në paragrafin 10 të nenit 93 (Kompetencat e Qeverisë), në lidhje me nenin 113 (Juridiksioni dhe palët e autorizuar) të Kushtetutës

së Republikës së Kosovës. Gjykata konkludoi se çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës nuk hyjnë në fushëveprimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113 të Kushtetutës. Rrjedhimisht,

në pajtim me nenin 113, paragrafi 1, të Kushtetutës, dhe me rregullin 59 (2) të Rregullores së punës, Gjykata njëzëri vendosi: Ta deklarojë kërkesën të papranueshme", është thënë në njoftimin e Gjykatës Kushtetuese.



përmbahen nga manipulimet



thënë Beqaj. Ai ka treguar për prurjet që ka për fushatën zgjedhore e cila do të fillojë më 25 shtator dhe do të zgjasë 10 ditë. Beqaj ka shfaqur drojën e tij se edhe kjo fushatë do të përfshihet nga premtimet populiste. "Simptomat e para tregojnë se do të potencohen premtimet populiste, siç është tarifa dhe manipulimet mediale siç është dialogu, lufta kundër korrupsionit, sundimi i ligjit.

Paradoksalisht premtimet e partive të vogla janë më reale, ndonëse për to më pak të arritshme, ndërsa premtimet e partive të mëdha që kanë qenë vazhdimisht në qeverisje janë në shpërputhje me veprimet e tyre", është shprehur ai.

Beqaj ka folur edhe për aderimet që subjektet politike po i bëjnë gjatë kësaj kohe. Sipas tij, ato tregojnë se partitë politike kanë dështuar me potencialin

ekzistues kadrovik. "Prurjet e reja janë dëshmi se partitë politike kanë dështuar me potencialin ekzistues kadrovik, ose nuk janë të kënaqur ose dëshirojnë për t'u bërë më të rëndësishëm sesa që aktualisht janë. Sidoqoftë, aderimet kadrovike para fushatës kanë më shumë efekte propagandistike sesa që realisht ngrehin kualitetin e partisë dhe individit", ka thënë ai.

Beqaj nuk beson se mund të ketë

vonesa për krijimin e qeverisë se re derisa ka shtuar se prioriteti kryesor i saj do të jetë prioriteti i "miqve ndërkombëtarë". "Qeveria do të konstituohet dhe prioriteti i parë i qeverisë do të jetë prioriteti i 'miqve ndërkombëtarë'. Fatkeqësisht, keqqeverisja e deritanishme i ka bindur ndërkombëtarët se partitë politike të Kosovës dhe lidreshipi politik i tyre vazhdimisht e kanë pasur prioritet pushtetin para shtetit dhe kombit", është shprehur ai.

"Epoka e re": Z. Beqaj, pas shpalljeve të zgjedhjeve të parakohshme të gjitha subjektet politike e kanë nisur një parafushtë, duke prezantuar prurjet e reja dhe duke u takuar me grupe të qytetarëve. Si e keni parë këtë aktivitet të tyre?

Beqaj: Mobilizimi i partive politike në kohën e zgjedhjeve politike nacionale është i natyrshëm. Nuk është e natyrshme pse ata deri në zgjedhje nuk kanë qenë mobilë. Prurjet e reja janë dëshmi se partitë politike kanë dështuar me potencialin ekzistues kadrovik, ose nuk janë të kënaqur ose dëshirojnë për t'u bërë më të rëndësishëm sesa që aktualisht janë. Sidoqoftë, aderimet kadrovike para fushatës kanë më shumë efekte propagandistike sesa që realisht ngrehin kualitetin e partisë dhe individit. Partitë serioze, nëse nuk dëshirojnë të kenë udhëtarë që kanë hipur në "autobusin e gabuar", më mirë është që aderimet t'i bëjnë para zgjedhjeve sesa gjatë fushatës.

"Epoka e re": Tashmë është bërë zakon që në parafushtatë dhe gjatë fushatës subjektet politike të bëjnë pretime të mëdha dhe të pambuluara. A mendoni se liderët politikë dhe kandidatët për kryeministër duhet të përmbahen nga premtimet e tilla?

Beqaj: Fushata s'ka kuptim nëse nuk shpalosen programet dhe vizionet, por premtimet joreale e bastardojnë fushatën. Prandaj, kandidatët për kryeministër dhe deputetë duhet të përmbahen nga manipulimet dhe lajthitjet. Ata mund të mashtrorjnë gjatë fushatës votuesit, por do të humbin besimin pas zgjedhjeve. Subjektet mashtrorjnë një herë,

dy herë, por besoj se nuk munden vazhdimisht. Edhe pse, dorën në zemër, realiteti kosovar ka dëshmuar se ka mjaft votues që preferojnë të ushqehen me rrena dhe mashtrime!

"Epoka e re": Çfarë pritni që do ta karakterizojë këtë herë fushatën zgjedhore? Do të kemi prezantim të mirëfilltë të programeve të partive?

Beqaj: Simptomat e para tregojnë se do të potencohen premtimet populiste, siç është tarifa dhe manipulimet mediale siç është dialogu, lufta kundër korrupsionit, sundimi i ligjit. Paradoksalisht premtimet e partive të vogla janë më reale, ndonëse për to më pak të arritshme, ndërsa premtimet e partive të mëdha që kanë qenë vazhdimisht në qeverisje janë në shpërputhje me veprimet e tyre derisa kanë qenë në forma të ndryshme në pushtet. Enigma e vetme është LV-ja, e cila mbetet të sprovohet.

"Epoka e re": Kemi katër subjekte politike të cilat po pretendojnë se do të jenë fituesi në këto zgjedhje. Si e parashikoni 6 tetorin? Kush do të jenë dy pretendentët kryesorë për fitore?

Beqaj: Unë, sa kam problem t'u besoj sondazheve, po aq kam problem ta kuptoj votimin e popullit tim, i cili ka dëshmuar historikisht se nuk është në gjendje për të mësuar nga pesimist! Dorën në zemër, zgjedhje të vogla ka, prandaj frikohem se do ta bëj gabimin e madh.

"Epoka e re": Në bazë të këtij grupimi të partive politike, a mendoni se do të jetë problem formimi i qeverisë së re pas zgjedhjeve, dhe cili do të jetë prioriteti i parë i asaj qeverie?

Beqaj: Qeveria do të konstituohet dhe prioriteti i parë i qeverisë do të jetë prioriteti i "miqve ndërkombëtarë". Fatkeqësisht, keqqeverisja e deritanishme i ka bindur ndërkombëtarët se partitë politike të Kosovës dhe lidreshipi politik i tyre vazhdimisht e ka pasur prioritet pushtetin para shtetit dhe kombit. Edhe këtë herë, fatkeqësisht, do të jetë kështu, derisa Kosova të mos krijojë lidreship të ndershëm dhe të aftë!

Mbi 25 vjet burgim për personat që planifikuan sulm ndaj KFOR-it

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Gjykata Themelore në Prishtinë i ka shpallur fajtorë gjashtë të akuzuarit për vepra penale që lidhen me terrorizëm, Bujar Behramin, Resim Kastratin, Gramos Shabanin, Albert Ademajn, Leotrim

Musliun dhe Edona Halitin. Ata akuzohen se kishin planifikuar të sulmonin një kishë, dy diskoteka, si dhe të kryenin sulme të tjera ndaj trupave paqeruajtëse të KFOR-it.

Të akuzuarit janë shpallur

fajtorë dhe janë dënuar me 25 vjet e 9 muaj burgim nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Lajmin për "Radion Evropa e Lirë" e ka konfirmuar Mirlinda Gashi, zëdhënëse e kësaj gjykate.

Bujar Behrami është dënuar

me 10 vjet burgim, Besim Kastrati me 4 vjet burgim, Resim Kastrati e Gramos Shabani me nga 7 vjet, Edona Haliti me një vit, kurse me 1 vit e 6 muaj burgim është dënuar Albert Ademaj si dhe me 2 vjet e 3 muaj burgim

është dënuar Leotrim Musliu.

Të dënuarit gjatë seancave kishin mohuar pretendimet e Prokurorisë, duke thënë se nuk kishin planifikuar asnjë sulm terrorist si brenda ashtu dhe jashtë Kosovës.

WDF-ja dhe IKD-ja: Partitë të mos përfshijnë në lista persona që kanë probleme me ligjin



Kosova ka nevojë për sundim të ligjit dhe qeverisje të mirë, por kjo nuk mund të arrihet nëse në listat zgjedhore dhe në pozita të larta përfshihen persona që kanë probleme me ligjin. Kështu është thënë në tryezën me temë "Çfarë kandidatë ofrojnë partitë politike në zgjedhje" të organizuar nga Fondacioni i Uestminsterit për Demokraci (WFD) në partneritet me Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD). Ata u kanë bërë thirrje partive politike që të mos përfshijnë persona që kanë probleme me ligjin në listat e kandidatëve për zgjedhjet e 6 tetorit

EPOKA
ERE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Fondacioni i Uestminsterit për Demokraci (WFD), në partneritet me Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), të mërkurën kanë mbajtur tryezën me temë "Çfarë kandidatë ofrojnë partitë politike në zgjedhje". Qëllimi i kësaj tryeze ka qenë ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe partive politike rreth mospërfshirjes së personave që janë nën hetime, me aktakuzë apo me aktvendime gjyqësore si

kandidatë për deputetë në zgjedhjet e 6 tetorit.

Drejtues i WFD-së në Kosovë, Fitim Mulolli, ka thënë se dekriminalizimi i partive politike duhet të ndodhë për disa arsye, duke nisur nga fakti se partitë politike janë përfaqësues të vullnetit të popullit dhe bartës të proceseve shoqërore të çdo vendi demokratik dhe, si rrjedhojë, veprimet e politikanëve në çdo nivel duhet të jenë të dinjitetshme, me integritet dhe të përgjegjshme. Ai ka thënë se prania në lista zgjedhore e personave që kanë probleme me ligjin

reflekton negativisht mbi tërë Kosovën dhe qytetarët e saj. "Kur personat me prapavijë korruptive ose penale marrin poste vendim-marrëse, ata menaxhojnë me shuma të mëdha të mjeteve të mbledhura nga taksat e qytetarëve të Kosovës, çka paraqet rrezik të madh për keqpërdorimin e taksave të qytetarëve", ka theksuar ai.

Si arsye të tretë, Mulolli ka përmendur aspektin ndërkombëtar apo integrimin evropian dhe marrëdhëniet me jashtë, për çka ka thënë se prania e personave që

kanë probleme me ligjin në institucionet më të larta politike si Kuvendi dhe Qeveria i japin një imazh shumë të keq Kosovës ndërkombëtarisht. Kurse Betim Musliu, hulumtues i lartë në IKD, ka thënë se trendi i kandidatëve që kanë pasur probleme me ligjin është rritur në vitet e fundit. "Trendi i këtyre kandidatëve të cilët kanë pasur probleme me ligjin në zgjedhjet e vitit 2010 ka degraduar dhe është rritur në vazhdimësi si në zgjedhjet e vitit 2014, po ashtu në të fundit të vitit 2017. Një numër bukur i madh i tyre kanë arritur të jenë pjesë e listave të partive politike dhe të njëjtët janë votuar nga qytetarët dhe janë zgjedhur deputetë në Kuvendin e Kosovës. Degradimi ka vazhduar në pushtetin ekzekutiv, ku përzgjedhja e ministrave dhe zëvendësministrave është bërë edhe prej njerëzve që kanë pasur aktakuza dhe dënime", ka

deklaruar Musliu. Sipas Musliut, sistemi i drejtësisë në Kosovë ende nuk u përshatet nevojave të qytetarëve për ta bërë gjykimin në bazë të provave dhe dënimeve, e jo agjendave të caktuara. Sipas WFD-së dhe IKD-së, kjo problematikë mund të zgjidhet përmes kornizës ligjore, përmes përjashtimit institucional dhe përmes rregullave dhe politikave të partive politike.

Të pranishmit në këtë tryezë janë pajtuar se Kosova ka nevojë për sundim të ligjit dhe qeverisje të mirë, por kjo nuk mund të arrihet me propozimin e kandidatëve që kanë probleme me ligjin, me theks të veçantë atyre që kanë të bëjnë me krim të organizuar, korrupsion dhe shpëlarje parash. Në këtë drejtim ata u kanë bërë thirrje partive politike që të mos përfshijnë persona që kanë probleme me ligjin në listat e kandidatëve për zgjedhjet e 6 tetorit.

Ministri i Drejtësisë bën thirrje që të nënshkruhet Pakti Kundër Korrupsionit



PRISHTINË, 4 SHTATOR - Ministri i Drejtësisë, Abeler Tahiri, ka kërkuar nga partitë politike që ta mbështesin iniciativën e kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli dhe ta nënshkruajnë Paktin Kundër Korrupsionit. Ai ka thënë se lufta kundër korrupsionit dhe abuzimit me pushtetin nuk luftohet vetëm nga organet e drejtësisë, por edhe nga parandalimi i kulturës abuzive dhe shfuqizimi i akteve të korrupsionit. "Nisma

e kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, z. Kadri Veseli, e prezantuar dje si Pakt Kundër Korrupsionit, shënon një momentum të ri kundër korrupsionit, nepotizmit dhe abuzimit. Si i tillë, ky pakt është në përputhje me frymën e ndryshimeve ligjore që kam ndërmarrë në dy vjetët e mandatit si ministër i Drejtësisë dhe në frymën e dekriminalizimit të sferës politike, çështje më se e domosdoshme për të siguruar një qeverisje efikase, të përgjegjshme

dhe llogaridhënëse", ka deklaruar Tahiri. Sipas tij, një përpjekje e tillë duhet të jetë shembull i politikëbërjes dhe standard i përhershëm në mes të subjekteve politike që marrin pjesë në zgjedhjet e tetorit e, po ashtu, një standard që duhet të vlejë në çdo periudhë vijuese.

Tahiri ka thënë se është jetike që qytetarët të kenë mundësi të zgjedhin për përfaqësim kandidatë me integritet të cilët nuk janë të dyshuar për korrupsion

dhe keqpërdorim të pushtetit dhe që nuk kanë rënë ndesh me ligjin. "Me këtë rast i ftoj të gjitha partitë politike që ta ndjekin shembullin e z. Veseli dhe ta nënshkruajnë Paktin Kundër Korrupsionit si shprehje e vendosmërisë dhe gatishmërisë për të ndërtuar një frymë të re politike kundër korrupsionit, kundër abuzimit me pushtetin dhe shkaqeve që mundësojnë keqpërdorimin", ka theksuar ai.

Migjen Kelmendi i bashkohet PDK-së

Gazetari dhe publicisti i njohur Migjen Kelmendi të mërkurën i është bashkuar PDK-së. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, liderin e rok bendit "Gjurmët" e ka quajtur ikonë të Prishtinës. Veseli ka thënë se PDK-ja është e nderuar që ekipit të tij të ri i është bashkuar një prej djemve më të mirë të Prishtinës

"Epoka e re"

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Gazetari dhe publicisti i njohur Migjen Kelmendi të mërkurën i është bashkuar PDK-së. Lajmin e ka bërë me dije lideri i PDK-së, Kadri Veseli. Në profilin e tij në "Facebook", Veseli ka shkruar se Kelmendi është një prej ikonave të Prishtinës dhe një prej djemve më të mirë të saj. "Të gjitha rrugët çojnë në PDK. Migjen Kelmendi ka lënë shenjat e tij në historinë e Kosovës, me art, me publicistikë, me angazhim intelektual në luftë dhe në paqe. Gjurmët e tij tani do t'i shohim edhe në ndërtimin e së ardhmes

së shtetit tonë. PDK-ja është e nderuar që ekipit të saj të ri prej sot i është bashkuar një prej ikonave të Prishtinës, një prej djemve më të mirë të saj. Mirë se erdhe, Migjen!", ka shkruar Veseli.

Lideri i rok bendit "Gjurmët" gjatë ceremonisë së bashkimit të tij me PDK-në është pritur me entuziazëm nga qindra të rinj të PDK-së në Parkun e Gërmisë në Prishtinë, të cilët i dëshiruan mirëseardhje.

Edhe Lëvizja Vetëvendosje ka vazhduar t'i prezantojë aderimet e veta. Lideri i këtij subjekti politik ka treguar se kësaj lëvizje i janë bashkuar tre profesorë, Astrit Rexhepi, Ardiana Veseli



dhe Mufail Salihaj. Në profilin e tij në "Facebook", Kurti i ka vlerësuar lart profesorët të cilët ia kanë bashkangjitur subjektit të tij politik. "Me qeverisjen e

Lëvizjes Vetëvendosje dhe me angazhimin e dijeve dhe të përvojës së profesionistëve të zotë, do të shohim një gjallërim në të gjitha fushat e jetës e të

shoqërisë në Kosovë si dhe një shtim të larmisë së ekonomisë së vendit. Fara e zhvillimit është mbjell tashmë", ka shkruar Kurti.

Koalicioni AAK-PSD e ka gati listën e kandidatëve për deputetë



PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kandidati për kryeministër i koalicionit AAK-PSD, Ramush Haradinaj, ka mbajtur mbledhje me kryetarët e degëve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në të cilën ka marrë pjesë edhe kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti. Pas takimit, Haradinaj ka thënë se e ka të pamundur t'ia ndalojnë kandidimin për deputet ndonjë anëtar të partisë me aktakuzë. Sipas tij, kjo është detyrë e organeve të drejtësisë e jo të partisë. "Do të respektohen ligjet e Kosovës, por të drejtat që nuk ia ndalon ligji dikujt, e kem të pamundur

t'i ndalojmë ne. Ligji i Kosovës duhet të avancohet më shumë që të qartësohen këto situata", ka deklaruar Haradinaj. Kurse i pari i PSD-së, Shpend Ahmeti, ka thënë se ky koalicion tashmë gjithçka ka bërë gati për zgjedhje, përfshirë edhe listën me kandidatë. "Jemi plotësisht të përgatitur për këtë sfidë dhe pretendentët kryesorë për t'i fituar zgjedhjet. Jemi bërë gati edhe për tubimin e parë, jemi gati me kandidatët që do t'i dorëzojmë më 6 shtator. Programi është gati dhe tash mund të them që po ecim sigurt drejt fitores", ka thënë Ahmeti.

Osmani: T'u japim fund praktikave ku shteti ka hise në biznese

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kandidatja për kryeministër e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të mërkurën se duhet t'u jepet fund praktikave të tashme të shtetit. "Është kënaqësi që sot vizitojmë biznese

set e suksesshme të cilat janë krenaria e këtij vendi. Ne si LDK gjithnjë kemi dëshmuar se jemi miq të bizneseve jo vetëm nëpërmjet përkrahjes që i kemi dhënë me pako fiskale dhe me mundësi të tjera që të eliminohen barrier-

at procedurale por, mbi të gjitha, besojmë thellësisht se këto biznese kanë nevojë për barazi para ligjit. Barazia para ligjit është parakushti themelor që edhe të eliminohen monopolet, edhe të eliminohen skemat korruptive",

ka thënë Osmani. Ajo ka treguar se të enjten do të ketë draftin e parë të listës së kandidatëve për deputetë, derisa ka shtuar se më 6 shtator do të finalizohet lista e kandidatëve për deputetë nga radhët e kësaj partie.



BE-ja dhe FIQ-i ndajnë 8 000 euro për 20 ndërmarrës të rinj

PRISHTINE, 4 SHTATOR - Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë dhe Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) kanë ndarë 8 000 euro të nëngranteve për 20 "start-up" në fushën e bujqësisë dhe teknologjisë së komunikimit të informacionit.

Drejtori i programit FIQ, Kushtrim Lluka, ka theksuar se ky projekt ka për qëllim që të rinjtë të avancohen drejt ndërmarrësisë dhe punësimit. "Sot do të ndajmë 20 'start-up' për idetë më të mira. Kemi pasur interesim të madh në këtë projekt dhe kemi arritur t'i mbledhim 400 të rinj. Ka qenë e vështirë t'i përzgjedhim 100 prej më të mirëve për

ide të biznesit. 8 000 euro do të ndahen për 20 fituesit. Ky projekt është vazhdimësi e projekteve të financuara nga Zyra e BE-së në Kosovë. është programi i parë përshpejtues i iniciativave që kanë rol social edhe në rajon. Qëllimi ynë është të ofrojmë një sistem drejt ndërmarrësisë dhe punësimit", është shprehur Lluka.

Ndërsa përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Riccardo Serri, ka thënë se do të vazhdojnë t'i mbështesin të gjithë të rinjtë e Kosovës. Ai ka thënë se projekti në fjalë është mundësi që të rinjtë ta përmirësojnë shtetin dhe të ardhmen e tyre. "I inkurajoj të

gjithë të rinjtë që të jenë pjesë e ndërmarrësisë. E mbështes këtë projekt me idetë e mëdha të të gjithë ju të rinjve. Ju jeni ata të cilët mund ta përmirësoni shtetin tuaj. Ju vini nga qytete të ndryshme, prandaj e vlerësoj përvojën e të gjithë juve. Që ta afirmoni përvojën tuaj, vizitoni vende të reja dhe mësoni nga shtetet e huaja që ta përmirësoni vendin tuaj. Ky projekt është i suksesshëm veçanërisht për jetën tuaj dhe për të ardhmen tuaj", ka thënë Serri. Ndërsa një nga fitueset e nëngranteve, Fjolla Ferati, ka folur për idenë e saj për zhvillimin e galerisë ku, siç ka thënë ajo, kjo galeri online do të



jetë galeria e parë në Kosovë. "Ideja jonë quhet 'Galeria Online' për bashkëpunimin të gjithë artistëve shqiptarë në një

shtëpi të artit. Kjo galeri ka nisur që nga viti 2014. Do të jetë galeria e parë në Kosovë", ka thënë Ferati.

Për gjashtë muaj 20 kompani gjermane kanë hapur degët e tyre në Kosovë



PRISHTINE, 4 SHTATOR (ER) - Drejtoresha e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK), Nora Hasani, ka bërë me dije thënë se gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2019, 20 kompani gjermane kanë hapur degët e tyre në Kosovë. Hasani në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se gjashtë prej këtyre kompanive

janë hapur me përkrahjen e OEGJK-së. "Sot pata nderin dhe kënaqësinë ta takoj deputetin e Bundestagut gjerman nga radhët e CDU-së, Peter Beyer. Biseduam për marrëdhëniet bilaterale ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë, për punën që e bën Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) për ruajtjen

dhe thellimin e partneritetit me Gjermaninë dhe për potencialin që ka Kosova për të tërhequr më shumë investitorë gjermanë. Vetëm gjatë gjashtëmuajorit të parë të këtij viti 20 kompani gjermane kanë hapur degët e tyre në Kosovë, 6 prej tyre me përkrahje nga OEGJK", ka shkruar Hasani.

Veseli: Mbështetja e sektorit të prodhimit, prioritet im kryesor

PRISHTINE, 4 SHTATOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe kandidati për kryeministër, Kadri Veseli, ka vizituar të mërkurën qendrën tregtare "Albi Mall", ku është pritur nga pronari i kësaj qendre, Tahir Humolli. Veseli ka thënë se "Albi Mall" është e kompletuar dhe konkurruese me qendrat tregtare të metropoleve evropiane. "Qendrat tregtare në Kosovë janë të kompletuara dhe konkurruese me ato të metropoleve evropiane.

Një e tillë është edhe 'Albi Mall', ku bashkë me pronarin Tahir Humolli vizituar disa biznese që operojnë aty dhe takuam qytetarë të shumtë. Kjo qendër dhe suksesi i saj dëshmojnë aftësitë e ndërmarrësve tanë, të cilët ecin me hapa të shpejtë përpara kur u jepet mundësia", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook". Veseli ka premtuar përkrahje për bizneset vendore në mënyrë që të ndërtohet një e ardhme më e mirë në

shtetin e Kosovës. "Në të ardhmen do të krijojmë sa më shumë hapësirë dhe mundësi që bizneset e tilla të zgjerohen dhe të punësojnë edhe më shumë të rinj. Po ashtu, prioritet kryesor për mua është mbështetja e sektorit të prodhimit, që këto qendra të mbushen me produkte vendore cilësore. Vetëm me një sektor privat të suksesshëm ne mund ta ndërtojmë një të ardhme më të mirë në vendin tonë", ka shkruar Veseli.



Dogana dhe AKB-ja pajtohen për bashkëpunim në përkrahje të bizneseve

PRISHTINE, 4 SHTATOR - Në kuadër të 20-vjetorit të Doganës së Kosovës, kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini dhe drejtori i Doganës, Bahri Berisha, kanë mbajtur konferencë për medie me temën "Dogana e Kosovës në shërbim të bizneseve dhe prodhuesve vendës".

Në këtë konferencë, kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se ndihet i vlerësuar që Dogana po bën vizitën e parë në organizatën që drejton. Sipas tij, kjo vizitë ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit reciprok për t'i mbështetur të gjitha bizneset në Kosovë.



"Diskutuum për tema të rëndësishme për afirmimin e Doganës dhe bizneseve të Kosovës. Pranë

juve janë dy organizatat më tak-sambledhëse dhe taksapaguese. Edhe pse ka pak probleme, në

krahasim me importe janë të vogla, por ne do të mundohemi që asnjë biznes mos të ketë probleme dhe të bëjmë rritje në këtë aspekt. Në kuadër të 20-vjetorit të Doganës së Kosovës ne kemi pasur kënaqësinë që jemi organizata e parë që na viziton për ta rritur bashkëpunimin reciprok dhe për të krijuar kulturë fiskale", ka thënë Shahini.

Ndërsa drejtori i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka thënë se ky institucion do të vazhdojë të jetë përkrahës i vazhdueshëm i bizneseve në vend. Ai ka thënë se në vitet në vazhdim Dogana do të

avancohet edhe më shumë për përkrahje të të gjitha bizneseve. "Dogana ka një rol të rëndësishëm për shtetin, veçanërisht për bizneset. Në fuqi janë ligjet që bizneset paguajnë doganat në kufi për mallrat e importuara. Dogana është për t'u vlerësuar lart. Dogana do të jetë përkrahës e të gjitha bizneseve qoftë në shkurtime dhe kostos kohore dhe financiare dhe do të jetë partner edhe në të ardhmen. Në dekadën e ardhshme do të jemi edhe më të avancuar për rritjen e bizneseve. Dogana është në shërbim të qytetarëve", ka thënë Berisha.

Haradinaj viziton kompaninë 'Meka', premtion përkrahje për prodhuesit vendorë



Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, gjatë qëndrimit në kompaninë "Meka" në Dregash ka premtuar përkrahje për prodhuesit vendorë. "Krahas reformave fiskale për lirimin e lëndës së parë nga TVSh-ja dhe lehtësirave të tjera, me këmbëngulje do ta vazhdojmë krijimin e klimës së volitshme për kompanitë vendore, që ta rrisin prodhimtarinë me cilësi të garantuar dhe ta shtojnë numrin e të punësuarve, duke iu siguruar pagë dhe kushte të dinjitetshme në Kosovë", ka thënë Haradinaj.

DRAGASH, 4 SHTATOR (ER) - Kryeministri në detyrë dhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka vizituar të mërkurën kompaninë "Meka" në Dragash, ku nga afër është njoftuar për planin zhvillimor të kësaj kompanie për të ardhmen dhe impaktin e taksës

100 për qind për ngritjen e kapaciteteve prodhuese. Gjatë kësaj vizite, Haradinaj është prituri në takim nga vëllezërit Burim dhe Ilir Piraj, të cilët janë pronarë të kësaj kompanie. Haradinaj ka thënë se kjo vizitë ka qenë një mundësi e mirë për të parë nga

afër punën e madhe që është duke bërë familja Piraj në përpunimin dhe prodhimin e mishit. "Nuk është e lehtë të punohet këtu ku jemi, me një lartësi mbidetare dhe me largësi nga zonat e tjera të ekonomisë dhe industrisë, por këta e duan vendin e vet dhe kanë punësuar një numër të madh të punëtorëve, rreth 80 që punojnë në kompaninë 'Meka', e cila shquhet për produkte që janë vërtet kualitative, që kanë fituar besimin edhe të qytetarëve të vendit, por edhe të tregjeve të jashtme", ka thënë Haradinaj.

Haradinaj ka thënë se ka vështirësi në rritje, por duke njohtuar pronarin e kompanisë "Meka", Burim Piraj, është shprehur i bindur për një të ardhme më të mirë të kësaj kompanie. "Jam i bindur se në të ardhmen do të

shohim një kompani shumë më të madhe të një zinxhiri ushqimor, edhe të atyre që sot importohet, ngase një pjesë të madhe të lëndës së parë kompania 'Meka' e importon nga Gjermania, e që do të mund ta siguronte edhe në Kosovë, por shpresoj se e ardhmja do të jetë e suksesshme, ashtu siç i ka planet për zhvillim", është shprehur Haradinaj.

Më tutje, Haradinaj ka thënë se, krahas reformave fiskale për lirimin e lëndës së parë nga TVSh-ja, me këmbëngulje do të vazhdojë krijimin e klimës së volitshme për kompanitë vendore. "Krahas reformave fiskale për lirimin e lëndës së parë nga TVSh-ja dhe lehtësirave të tjera, me këmbëngulje do ta vazhdojmë krijimin e klimës së volitshme për kompanitë vendore, që ta rrisin prodhimtarinë

me cilësi të garantuar dhe të shtojnë numrin e të punësuarve, duke iu siguruar pagë dhe kushte të dinjitetshme në Kosovë", ka thënë Haradinaj.

Ndërsa Burim Piraj, pronar i Kompanisë "Meka", ka falënderuar Haradinajn për vizitën, të cilit i ka prezantuar të arriturat, problemet dhe planet zhvillimore në të ardhmen. "Mendoj se me një bashkëpunim më të madh me institucionet tona do të kemi mundësi zhvillimore edhe më të mëdha jo vetëm për kompaninë tonë, por edhe për ekonominë vendore", është shprehur Piraj, duke theksuar se vizita e kryeministri në detyrë Haradinaj është dëshmi e një interesimi për prodhuesit vendorë, për prodhimin vendor dhe punësimin në përgjithësi.

Lluka: Sindikata e Telekomit ka qenë krah i qëndrimeve të mia për ta shpëtuar këtë ndërmarrje

Prishtinë, 4 shtator (ER) - Ministri në detyrë i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka prituri në takim kryetarin e Sindikatës së Telekomit të Kosovës, Lamih Balaj, me të cilin ka biseduar për gjendjen në këtë ndërmarrje publike. Lluka nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka shkruar se Sindikata e Telekomit të Kosovës ka qenë zëri kryesor i shpërfaqjes së problemeve të

brendshme të Telekomit. Në këtë kontekst, Lluka ka thënë se vetëm duke punuar me sinjeritet dhe duke pastruar Telekomit të Kosovës dhe çdo ndërmarrje tjetër publike do të bëhen të suksesshme dhe të vetëqëndrueshme. "Sindikata e Telekomit të Kosovës ka qenë zëri kryesor në dy vjetët e fundit, duke ngritur zërin për problemet e brendshme dhe duke ndihmuar Telekomin e Kosovës që t'i ndër-

presë veprimet e dëmshme. Gjatë kësaj periudhe të qeverisjes, sindikata e punëtorëve ka qenë krah i qëndrimeve të mia për të shpëtuar këtë ndërmarrje të rëndësishme dhe për të zhvilluar atë për një të mirë të përgjithshme. Për këtë e falënderoj kryetarin e sindikatës, Lamih Balaj dhe anëtarët e tjerë të cilët kisha kënaqësinë t'i pres sot në takim pune", ka shkruar Lluka.



Albanofobia në Maqedoninë e Veriut

(Fragment nga libri "Ballkani, diplomacia e munguar")



Shkruan: Prof. Lisen
BASHKURTI

Gjatë historisë së Jugosllavisë së AVNOJ-it, të krijuar nga komunistët jugosllavë me Josip Broz Titon menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945), Maqedonia ishte njësi federative që kishte shqiptarë brenda saj. Komuniteti shqiptar në Maqedoninë e Federatës Jugosllave ka përjetuar përgjithësisht një trajtim të diferencuar, pak a shumë të përafërt me atë të pakicave shqiptarë të shpërndara nga Tito në Republikën e Serbisë dhe Malit të Zi. Gjatë historisë së Federatës Jugosllave përjashtim ka bërë trajtimi i shqiptarëve në Slloveni dhe Kroaci. Në këto dy republika, pra në Kroaci dhe Slloveni, shqiptarët ndiheshin më të barabartë, më të padiskriminuar dhe të mirë integruar në shoqëritë e dominuara nga kroato-slovenët. Kroatët dhe slovenët i konsideronin shqiptarët si mbështetës të doktrinës së tyre federaliste, e cila synonte të mbante Jugosllavinë e fortë mbi një Serbi të dobët. Për kroatët dhe slovenët, shqiptarët ishin komuniteti etnokulturor i tretë i fuqishëm në Federatën Jugosllave, që ishte konsistent kundër Serbisë dhe përpjekjeve të saj për dominim të centralizuar mbi Federatën Jugosllave. Republika e Maqedonisë në kuadër të Federatës Jugosllave u krijua nga Tito si një njësi amortizimi midis pretendimeve etno-kulturore të bullgarëve (në lindje), shqiptarëve (në perëndim), grekëve (në jug) dhe serbëve (në veri). Në qendër të krijimit të Republikës Maqedonase qëndronte një komunitet i vogël maqedonasish, me origjinë dhe lidhje me një pakicë në Bullgari. Nga historia, kultura dhe gjuha ngjasonin tërësisht me bullgarët. Ishin një komunitet pa ndonjë identitet të veçantë historik, kulturor dhe gjuhësor. Jetesa thuhet se 50-vjeçare në kuadër të Federatës Jugosllave i krijoi hapësirë këtij

komuniteti të vogël maqedonas pa ndonjë identitet të veçantë, që të krijonte jetën e vet politike, institucionale, ekonomike dhe kulturore si dhe ta formonte elitën e vet intelektuale. Këto baza modeste shërbyen si themelet e krijimit të shtetit maqedonas mbas shpërbërjes së Federatës Jugosllave. Maqedonia, falë lidhjeve të saj të shumta me Serbinë, u nda nga Jugosllavia pa konflikte të armatosura, paqësish. Kjo ndarje i krijoi elitës maqedonase ndjenjën e supremacisë politiko-diplomatike dhe shtetformuese mbi komunitetet e tjera, duke përfshirë edhe shqiptarët, të cilët përbënin një komunitet shumë të madh në vend. Kjo ndjenjë supremacie, njëkohësisht nënvlefësuese ndaj shqiptarëve, i nxiti maqedonasit ta miratonin kushtetutën e parë të shtetit të pavarur, në të cilën Maqedonia shpallej shtet i maqedonasve. Pra, qysh në kushtetutë nisi diskriminimi ndaj shqiptarëve. Ky diskriminim erdhi duke u thelluar në aspektet politike, institucionale, ekonomike dhe sociale, arsimore dhe kulturore. Akumulimi i gjatë i diskriminimit etnik të shqiptarëve nga pala maqedonase provokoi krizë të marrëdhënies ndëretnike shqiptaro-maqedonase në vitin 2001. Kriza mori përmasat e konfliktit të armatosur midis UÇK-së (Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare) dhe Armatës Maqedonase (G. Ostreni: "Ushtria Çlirimtare Kombëtare", Dibër, 2014, faqe 140-153, ISSN 978-9989-2650-6-8). Vendi do të shkonte drejt shpërbërjes nëse nuk do të ndërhynte fuqishëm faktorët ndërkombëtarë, ShBA, BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Faktorët ndërkombëtarë nisën bisedimet intensive nga pranvera e vitit 2001 për të dizajnuar një draft-marrëveshje, e cila do të firmosej nga palët në konflikt, shqiptarët dhe maqedonasit si dhe nga faktorët ndërkombëtarë, ShBA-ja dhe BE-ja. Në gusht të vitit 2001, draftmarrëveshja mblodhi krerët e shtetit dhe të politikës së Maqedonisë, maqedonas dhe shqiptarë së bashku me ndërmjetësuesit ndërkombëtarë në Ohër (Ohrid Framework Agreement, August 2001). Mbas pak negociatash palët firmosën Marrëveshjen Kuadër të Ohrit, e cila hapi një faqe të re për shtet-

formimin demokratik të Maqedonisë mbi baza pluraliste demokratike dhe shumetnike. Lindi nevoja e ndryshimeve kushtetuese, ligjore dhe institucionale, nëpërmjet të cilave faktori etnik shqiptar shpallej element konstituiv shtetformues. Kushtetuta e re e vitit 2001 u dha fund ambicieve nacionaliste unitariste të maqedonasve. Për shqiptarët nisi një etapë e re. Por, proceset reale përparojnë, ndërsa historia rëndon si hije në perceptimet dhe ndjenjat e njerëzve. Kësaj dukurie nuk i shpëtoi dot as shoqëria maqedonase. Reminiscencat e diskriminimit të gjatë të shqiptarëve nën Maqedoninë Jugosllave (1945-1991), diferencat në zhvillimin ekonomik dhe social, arsimor dhe kulturor të shqiptarëve si qytetarë të dorës së dytë (1991-2000) si dhe pasojat e konfliktit ndëretnik shqiptaro-maqedonas (2000-2001) lanë gjurmë të thella në stereotipat albanofobe në shoqërinë maqedonase, e prej saj në jetën politike, institucionale, ekonomike dhe në fusha të tjera. Kështu, gjurmët më të thella në albanofobinë e maqedonasve i kanë lënë ngjarjet e vitit 2001. Maqedonasve iu duk sikur i ra shteti, liria, pavarësia dhe gjithçka që kishin ëndërruar. Kjo situatë ishte, thjesht, fikcion. Në fakt, ngjarjet e 2001 zbritën ëndrrat në realitete. Sidoqoftë, tensionet etnike të atij viti, ngjarjet e rënda, trageditë e shkaktuara, përkeqësuan shumë marrëdhëniet njerëzore shqiptaro-maqedonase. Me gjithë ndryshimet e mëdha pozitive që pasuan në Maqedoni mbas Marrëveshjes Kuadër të Ohrit, sërish niveli i albanofobisë nuk u fashit. Kësaj situatë i ndikuan shumë për keq jo vetëm politika e ditës, por edhe intelektualët dhe shkencëtarët maqedonas. Intelektualët dhe shkencëtarët e Maqedonisë, individualisht dhe institucionalisht, përmes Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve botuan në vitin 2009 enciklopedinë e parë të vendit. Në këtë enciklopedi shqiptarët pasqyroheshin me definicione joshkencore, denigruese dhe fyese. Shqiptarët quheshin nga shkencëtarët maqedonas në enciklopedi si primitivë, malësorë e të paqytetëruar. Duke falsifikuar gjithçka që shkencat shqiptare

dhe evropiane kishin zbuluar dhe konfirmuar për autoktoninë dhe autenticitetin e shqiptarëve në trojet e veta në Ballkan, shkencëtarët maqedonas në këtë enciklopedi shkruanin se shqiptarët paskëshin ardhur në Ballkan nga shekulli i XVI-të. Publikimi i enciklopedisë maqedonase provokoi reagime të forta të studiuesve shqiptarë në mbarë Ballkanin si dhe protesta të fuqishme qytetare. Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve u detyrua nën presion që ta tërhiqte enciklopedinë nga tregu (Nazim Rashidi, "Dënohet enciklopedia maqedonase". BBC. Retrieved, 28 November 2012). Albanofobia në Maqedoni ka përfshirë edhe sportet dhe sportdashësit. Kështu, në vitin 2012 tifozët e ekipit kombëtar të volejbollit të Maqedonisë fituan kundër Çekisë në Kampionatin Evropian që u zhvillua në Serbi. Mbas fitores me çekët, tifozët së bashku me sportistët maqedonas filluan të hidhnin slogane kundër shqiptarëve. Sikundër kemi pasur rast ta konstatojmë edhe në vende dhe popuj të tjerë, sporti, si një veprimtari shoqëror e mbarsur me shumë emocione reflekton, në fakt më shumë se në mjaft aspekte të tjera atë që fshihet si nënshtresë e ndjenjave të popujve për njëri-tjetrin (<http://alsatm.tv/lajme/vendi/110230.html>). E njëjta atmosferë albanofobe vijoi edhe gjatë e mbas ndeshjes me Danimarkën më 22 janar 2012 (<http://alsatm.tv/lajme/vendi/110668.html>). Nuk kanë munguar edhe albanofobët në radhët e klerit ortodoks maqedonas. Më 10 mars të vitit 2012 u shkarkua një video në "YouTube" nga një grup religjioz maqedonas i quajtur "Organizata kristiane", në të cilin jepeshin pamje duke u djegur flamuri shqiptar dhe duke bërë thirrje për bashkimin e të krishterëve kundër shqiptarëve me të vetmin qëllim për t'i përzënë ato nga vendi. (Arta Tozaj, "Macedonians burn Albanian flag", Top Channel. Retrieved 2012-03-12)

Media shqiptare prestigjioze, "Top Channal", e kritikoi ashpër këtë shfaqje ekstreme albanofobie dhe i bëri thirrje qeverisë maqedonase që të distancohej nga këto fobi që janë të rrezikshme për

vendin dhe marrëdhëniet shqiptaro-maqedonase. (<http://www.topchannel.tv/english/artikull.php?id=5466>; <http://alsatm.tv/lajme/vendi/127294.html>). Edhe pas më shumë se dhjetë vjetësh nga firmosja e Marrëveshjes Kuadër të Ohrit në Maqedoni incidentet albanofobe kanë vijuar në vazhdimësi dhe qëndrimi i qeverisë së këtyre viteve 2006-2014 (VMRO-DPMNE) nuk ka ndryshuar në këtë aspekt thuhet asgjë. Më 12 prill 2012 nga zyrtarët dhe mediet maqedonase u dha lajmi se pesë qytetarë maqedonas u vranë nga shqiptarë etnikë. Kjo ngjarje thuhet se ndodhi në liqenin "ezarsko. Rasti u epitetua si "Monstra". Mbas afër dy vjetësh Gjykata e Rajonit 1 të Shkupit dënoi grupin e akuzuar shqiptar me burgime të përjetshme. Avokatë, ekspertë, juristë, politikanë, intelektualë dhe gazetarë ngritën në këmbë tërë opinionin publik shqiptar, duke e quajtur këtë vendim gjykatë tërësisht politike dhe antishqiptare. Qindra mijëra shqiptarë u ngritën në manifestime proteste në Shkup, Tetovë, Kumanovë, Dibër, Strugë. Madje manifestime u zhvilluan edhe në Shqipëri, Kosovë, Amerikë, Angli, Gjermani, Zvicër e kudo ku ka emigrantë shqiptarë në botë. Reagime erdhën edhe nga diplomacia perëndimore, BE-ja dhe ShBA-ja. Në kundërreagim grupe etnike maqedonase organizuan kundër manifestime me parulla "Vdekje shqiptarëve", "Shqiptar i mirë është vetëm shqiptari i vdekur" dhe "Dhoma gazi për shqiptarët". Thuhet një vit më vonë, më 28 shkurt 2013, dhjetë fëmijë të vegjël shqiptarë u sulmuan fizikisht dhe u goditën me thika dhe objekte të forta nga gangsterë maqedonas me maska. Fëmijët u plagosën shumë rëndë dhe u dërguan urgjentisht për mjekim. Sipas të dhënave që deklaruan dëshmitarët okularë, ndonjëse policia u njoftua menjëherë, patrulla e saj erdhi në vendngjarje thuhet se 40 minuta më vonë, duke rrezikuar seriozisht jetën e fëmijëve (Alsat-M: "Incident, sulmohen dhjetëra nxënës shqiptarë", 28 February 2013).

Me incidente të mëdha u shoqërua edhe emërimi i ministrit të Mbrojtjes, shqiptari Talat

Gjilani shpërndan pesë krerë gjedhesh për fermerët

GJILAN, 4 SHTATOR (ER) - Komuna e Gjilanit, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë, në bazë të memorandumit të bashkëpunimit me shkollën e agrobiznesit "Arbëria", ka shpërndarë pesë krerë gjedhesh për fermerët gjilanas. Nënkrjetari i Komunës, Arbër Ismajli, ka deklaruar se ky aktivitet dëshmon se kjo shkollë

është në shërbim të fermerëve. Ndërsa drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, ka deklaruar se nga ky donacion kanë përfituar fermerët më të mirë. "Pas memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar në mes të Drejtorisë së Bujqësisë dhe shkollës së agrobiznesit 'Arbëria', sot po zbatojmë projektin e dytë, apo donacionin nga kjo shkollë

dhe përmes thirrjes publike i kemi përzgjedhur pesë fermerët më meritore për pesë krerë gjedhesh. Të njëjtën sasi e kemi shpërndarë edhe në muajin shkurt. Urime përfituesve!", ka thënë Ramadani. Ndërsa drejtori i shkollës së agrobiznesit "Arbëria", Xhelal Jetishi, ka thënë se kjo praktikë do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm.



Xhaferi, nga komuniteti maqedonas mbas zgjedhjeve të parakohshme të vitit 2014. Protestuesit maqedonas reagues me mjete dhune, me gurë dhe përlëshje kundër këtij emërimi. U plagosën tre civilë dhe rreth pesë policë në këto manifestime të dhunshme si dhe u bënë dëme të mëdha mbi bizneset dhe pronat private. Gjithashtu, u plagosën edhe pesë infermierë të shërbimit mjekësor me origjinë shqiptare. Flamuri shqiptar u dogj në mënyrë demonstrative (Alsat-M: "Protesta e huliganëve para Qeverisë, digjet edhe flamuri shqiptar". 2 March 2013).

Në vazhden e incidenteve albanofobe në Maqedoni, më 3 mars 2013 një vajzë etnike shqiptare u qëllua në Shkup nga dy burra maqedonas me maska. Gangsterët maqedonas e goditën vajzën e pafajshme shqiptare me raketa bejsbolli dhe me thikë në fytyrë (Alsat-M: "Sulmohet nxënësjë në Shkup. MPB deklarata e nxënëses kontradiktore", 20 March 2013). Po në të njëjtën javë, një djalë i vogël shqiptar në moshën 10-vjeçare u sulmua nga një gangster maqedonas me maskë. Huligani maqedonas e goditi rëndë djalin e vogël shqiptar sepse ky i fundit refuzoi që ta puthte kryqin ortodoks maqedonas. Djali i vogël shqiptar ishte i besimit mysliman (Alsat-M: "Sulmohet nxënësjë në Shkup. MPB deklarata e nxënëses kontradiktore". 20 March 2013).

Në tërësi e vështuar nga ana sasiore, Komiteti i Helsinkit në Republikën e Maqedonisë konstaton se më datë 23 korrik 2014, në këtë vend, për një periudhë 12-mujore nga viti 2013-2014 janë shtuar konfliktet ndëretnike midis shqiptarëve dhe maqedonase. Komiteti i Helsinkit (KH) vetëm për një vit ka regjistruar 175 krime të nxitura nga urrejtja, shumica e të cilave ose 128 janë cilësuar si incidente me motive etnike. Këto të dhëna u paraqitën me rastin e Ditës Evropiane të Viktimave të Krimin të Urrejtjes. Komiteti i Helsinkit kritikon shtetin për mosregjistrimin e rasteve të nxitura nga urrejtja etnike dhe mosdënimin e tyre me qëllim parandalimi. Drejtoresha e KH-së, Urania Pirovska, deklaroi se incidentet e shumta me motive etnike dëshmojnë se në Maqedoni toleranca mes komuniteteve mungon. Konkretisht raporti në fjalë thekson: "Sot dolëm me të dhëna se në platformën e Komitetit të Helsinkit janë regjistruar 175 raste dhe incidente të nxitura nga urrejtja. Madje 128 prej tyre kanë motive etnike.

Rastet e fundit të lidhura me rastin 'Monstra' edhe një herë e vërtetuan se si janë marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni. Viktimat e këtyre rasteve, shumica janë pjesëtare të dy grupeve më të mëdha etnike, asaj maqedonase dhe shqiptare dhe në të shumtën e rasteve janë të mitur" (Urania Pirovska: "Shtohen incidentet ndëretnike në Maqedoni", Balkanweb.com. Komiteti i Helsinkit, 23 korrik 2014). Sikundër shikohet nga pasqyra e rëndë dhe e vazhdueshme e situatave, ngjarjeve dhe incidenteve në Maqedoni, në disa raste edhe tragjike, gjendja e albanofobisë në atë vend është e rëndë, e përhapur gjithandej, në mjedisë, vende dhe kategori të ndryshme të shoqërisë maqedonase. Më shqetësues është fakti se strukturat shtetërore, qeveritare, politike, sikundër edhe ato intelektuale, akademike dhe klerikale jo vetëm nuk punojnë për të zbutur këtë situatë, por shpeshherë janë bërë pjesë e mbajtjes gjallë dhe e përkeqësimit të saj. Maqedonia, duke qenë një shtet dhe shoqëri me përbërje shumetnike në të cilën faktori shqiptar është kushtetues dhe ekzistencial për vetë atë, marrëdhëniet ndëretnike mbeten përcaktuese për ruajtjen e unitetit të shtetit dhe të kohezionit social të shoqërisë. Në këtë kuptim, në rastin "Maqedoni", albanofobia është direkt kundër interesave të maqedonasve dhe shtetit që po ndërton. Aktualisht në Maqedoni vijon të ketë një asimetri midis përbërjes shumetnike, me determinim shqiptaro-maqedonas dhe politikës, sjelljes dhe qëndrimeve zyrtare dhe institucionale albanofobe. Përderisa kjo asimetri do të vazhdojë të ekzistojë me këto përmasa dhe shtrirje, Maqedonia do të përfshihet herë pas here në kriza politike dhe ndëretnike që do ta gërryjnë unitarizmin e shtetit, funksionimin e demokracisë, bazat e ekonomisë dhe biznesit si dhe kohezionin social të mbarë shoqërisë. Strukturat politike shqiptare në Maqedoni, partitë kryesore BDI dhe PDSH janë mjaft të konsumuara politikisht dhe të kompromentuara me bashkëqeverisjet maqedonase, sa që e kanë humbur shumë besimin të shqiptarët etnikë. Ndërsa faktorët shqiptarë jashtë Maqedonisë politike, kryesisht shteti shqiptar dhe shteti i Kosovës, kanë qenë aktivë, njëkohësisht edhe shumë të vetëpërbajtur me qëllim që të mos ndikojnë në destabilitetin e mëtejshëm të këtij vendi dhe të mbarë Ballkanit Perëndimor.

Vihet gurthemeli për ndërtimin e shkollës në Fortesë të Rahovecit

RAHOVEC, 4 SHTATOR (ER) - Në fshatin Fortesë të Rahovecit është vënë gurthemeli për ndërtimin e objektit të ri të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Liria", projekt ky i cili kap shumën 759 mijë euro. Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se ndërtimi i kësaj shkolle ka qenë jetik për nxënësit dhe mësimdhënësit e fshatit Fortesë. Ai ka theksuar se kjo shkolle do t'i plotësojë nevojat për mësimdhënie dhe mësimnxënie pasi, krahas shkollës, do të ketë edhe objekte të tjera përcjellëse. Latifi ka deklaruar se renovimi i shkollës së mëhershme ka qenë i pamundur pasi pozita e shkollës ka qenë jo e përshtatshme dhe në kohën e shirave gjithnjë është vërshuar. "Objekti i ri i Shkollës Filllore 'Liria' në Fortesë ka qenë jetik dhe më se i nevojshëm dhe i domosdoshëm pasi objekti ekzistues është në pikën më të ulët dhe sa herë që ka rënë pak shi, pothuajse kati i parë ka qenë i



mbuluar me ujë. Dhe asnjë mundësi për renovim të objektit ekzistues nuk ka pasur sepse investimet do të ishin të paqëndrueshme. Si rezultat i një analize të njerëzve që e njohin këtë fushë kemi marrë rekomandim që të nisim një objekt të ri që është funksional, që ka edhe sallën e edukatës fizike dhe mjediset përreth shkollës do të

qenë të rregulluara mirë. Standardet e kushteve që do t'i plotësojë për mësimdhënie dhe mësimnxënie janë të larta. Vlera e kontratës është 759 mijë e ca euro", ka thënë Latifi. Ndërsa drejtori i Shkollës Filllore "Liria", Elhami Zhuniqi, ka thënë se ndërtimi i shkollës së re do të ndikojë në rritjen e cilësisë në arsimim.

Begaj: Policia e Kosovës, krenaria jonë

MALISHEVË, 4 SHTATOR (ER) - Me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës, Stacioni Policor në Malishevë të mërkurën i ka mbajtur dyert e hapura për qytetarë. Me këtë rast kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i shoqëruar edhe nga Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Valon Gashi dhe shefja e kabinetit të kryetarit, Blerta Krasniqi, e kanë vizituar Stacionin Policor në Malishevë, ku janë pritur nga komandanti i stacionit, kapiteni Azem Krasniqi dhe zyrtarët e tjerë policorë.



Kryetari Begaj në emër të qytetarëve të Malishevës ka uruar Policinë e Kosovës për 20-vjetorin e themelimit. "Në emër të Komunës së Malishevës, qeverisë komunale dhe në emrin tim personal, ju uroj për këtë ditë, përkatësisht 20-vjetorin e themelimit të Policisë së Kosovës. Ju jeni krenaria jonë, pasi me punën dhe angazhimin

e juaj, jeni duke krijuar siguri për qytetarët pa dallim", ka thënë Begaj. Më tutje, ai ka thënë se është krenari dhe nder i madh t'i shërbesh vendit. Ndërsa komandanti i Stacionit Policor në Malishevë, kapiten Azem Krasniqi, pasi ka falënderuar kryetarin Begaj për vizitën, ka thënë se policia është në

shërbim të qytetarëve. "Ne jemi në shërbim të qytetarëve dhe jemi duke u munduar që detyrën tonë në shërbim të vendit, ta kryejmë në mënyrën më të mirë të mundshme, me qëllim të mbajtjes së një ambienti dhe situatë të sigurt për të gjithë qytetarët pa dallim", ka thënë Krasniqi.

Shkolla "Jusuf Gërvalla" në Prapaqan bëhet me kënd të lojërave

Deçan, 4 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, së bashku me nënkryetarin Sami Cacaj dhe bashkëpunëtorë të tjerë kanë bërë përrurimin e këndit të lojërave për fëmijë në shkollën "Jusuf Gërvalla" në fshatin Prapaqan të kësaj komune. Ky projekt është realizuar falë bashkëpunimit në mes të "GLV-Gjeravica", Ministrisë së

Bujqësisë dhe Komunës së Deçanit. Me këtë rast, kryetari Ramosaj ka thënë se këndi i lojërave në shkollën "Jusuf Gërvalla" ka qenë i mirëseardhur për të gjithë, sidomos për nxënësit e kësaj shkolle. Ndërsa kryetari i Bordit të "GLV-Gjeravica", Bajram Çeku, ka thënë se ky projekt për këtë fillim të vitit të ri shkollor është dhuratë për nxënësit nga Ministria e

Bujqësisë dhe Komuna e Deçanit. Në këtë kontekst, ai ka bërë me dije se projekti për këndin e lojërave është implementuar nga "GLV-Gjeravica", e cila, sipas tij, në vazhdimësi ka realizuar projekte të ndryshme në të mirë të banorëve të zonave rurale në Komunën e Deçanit. "Ky nuk do të jetë projekti i fundit për këtë vit. Planifikojmë edhe projekte të tjera", ka thënë Çeku.



E rrallë

Një substancë misterioze zbulohet në Hënë

Të habitur nga zbulimi, ekipi i kontrollit të roverit kinez "Yutu-2" ka thirrur ekspertët dhe shtyrë kërkimin e planifikuar për një ekzaminim më të detajuar të një materiali të çuditshëm në Hënë. Sonda "Chang'e-4", e nisur më 7 dhjetor 2018, ka qenë në hemisferën jugore që nga 3 janari 2019. Në mes të një misioni shkencor të vazhdueshëm, roveri "Yutu-2" ka zbuluar një material të çuditshëm në Hënë. Sipas "Daily Express", një



nga shkencëtarët kinezë ka vënë re fotografi të pazakonta të bëra me kamerën kryesore të roverit, duke treguar një krater të vogël, i mbushur pjesërisht me një substancë të pashpjegueshme, ku ngjyra dhe shkëlqimi raportohet se janë të ndryshme nga mjedisi rrethues.

FOTO E DITES




Një person bartë një thes plot me shishe plastike në njërin nga deponitë në Madagaskar. /Reuters/

E jashtëzakonshme

Qelizat e kancerit vdesin në hapësirë

Mjaftojnë 24 orë pas vendosjes së tyre në gjendjen e mungesës së gravitetit dhe më shumë se 80 për qind e qelizave kancerogjene të vdesin. Studiuesit australianë e kanë parë një gjë të tillë të ndodhte në laborator, e tani ata janë duke kërkuar që një gjë të tillë ta shohin edhe në realitet. Për këtë arsye, ata kanë në plan



të dërgojnë qeliza kancerogjene në hapësirë për të parë sesa

ndikon vërtet mungesa e forcës së rëndësës, e të ketë efekt mbi sëmundjen e rëndë. Joshua Chou, nga universiteti teknologjik i Sydneyt, ka thënë se shumë vetë nga shoqëria e tij ishin sëmurë papritur me kancer dhe kjo e kishte motivuar të studioje se çfarë ndodh me qelizat e kancerit.

BARSOLETA E DITËS



Vajza: Nënë, jam në lidhje me një djalë!
Nëna: A është djalë i mirë?
Vajza: Ka veturë shumë të mirë.
Nëna: Mos ia shiko veturën, se fëmijët nuk i ngajnë asaj, por shoferit!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
 Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
 Regjia: David Leitch



Çdo natë në ora 21:30 ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min


Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Të qëndroni vetëm është diçka e mirë, por jo deri në pikën sa izoloni veten. Nëse qëndroni vetëm për të mos u përballur me dikë apo diçka, jeni gabim. Ju duhet të mësoni të përbaloni atë që ju mërztit.</p>	 <p>DEMI Mund të keni ndjenjën e xhelozisë, e cila shkaktohet vetëm për shkak të pasigurisë. Nëse ndiheni të pasigurt në punë, në historinë e dashurisë apo në familje, është momenti të gjeni arsyen e vërtetë. Xhelozia mund t'iu prishë punë.</p>	 <p>BINJAKËT Ju mund të ndjeni vetëbesim të ulët sot për shkak të pamjes së jashtme. Në vend që të shani veten, gjeni mënyra për të pranuar pamjen tuaj, qoftë kjo e bazuar tek moshja, pesha apo diçka tjetër.</p>	 <p>GAFORRJA Xhelozia mund t'ju pushtojë "kokën" sot. Ajo që ju duhet për të dalë nga kjo situatë është të kuptoni përse ndiheni të pasigurt. Nëse ndiheni xhelozë për partnerin/partneren, pyesni veten përse.</p>	 <p>LUANI Arti dhe veprat artizanale mund t'ju tërheqin vëmendjen. Edhe nëse merreni me sport, diçka artistike do iu bjerë në sy menjëherë. Lejoni veten që të eksploroni në këtë fushë pasi do kuptoni se keni aftësi të mëdha.</p>	 <p>VI RGJËR ESHA Sot mund t'ju duket sfidë që të qëndroni me të tjerët. Aspektet planetare ju kanë bërë që të izoloni veten. Mund të jeni të paduruar dhe zemëroheni shpejt. Nëse është situata kështu, qëndroni vetëm.</p>
 <p>PESHORJA Mos u surprizoni nëse ndjeni mall për ditë. Influenca planetare ju bëjnë të jeni më sensitivë. Lëreni vete të qani nëse keni nevojë. Përpikuni të qetësoheni sepse gjërat do jenë më ndryshe nesër.</p>	 <p>AKREPI Mendimet e thella mund të jenë ato që doni sot. Do të qëndroni në zona ku mund të mendoni për paratë, pushtetin, suksesin dhe romancën. Por nëse fiksoheni me këtë, duhet të flisni me dikë.</p>	 <p>SHIGJETARI Mundohuni të mos jeni impulsivë. Mund të bëheni shpejt konfuzë, por thellohuni më shumë kur nuk bëni dot një zgjedhje. Sa i përket lidhjeve të dashurisë, mos merrni vendime të shpejta.</p>	 <p>BRICJAPI Nëse keni bërë disa përpjekje për të zgjidhur një situatë e nuk ia keni dalë, konsiderojeni vendimin që keni në mendje. Mendojini gjërat me kujdes dhe ndani idetë me një mik të besueshëm.</p>	 <p>UJORI Prekni kreativitetin tuaj për të zhbllokuar emocionet tuaja sot. Kjo mund të jetë më e fuqishme sesa ju mendoni. Kreativiteti është pjesë e rëndësishme e juaja, po aq sa komunikimi.</p>	 <p>PESHQIT Mund t'ju duhet të bini dakord me diçka që nuk pëlqeni. Këtë duhet ta bëni pasi ju vjen nga dikush sipër jush ose një figurë autoritare, ndoshta prind ose mësues.</p>



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

'Profa' ka synime të mëdha me Prishtinën

Bylbyl Sokoli të mërkurën është prezantuar trajner i Prishtinës para futbollistëve "bardhekaltër". Ai ka bërë me dije se me kryeqytetasit do të luftojë për kreun e tabelës. "Prishtina ka skuadër cilësore dhe objektiva të qarta. Për këtë arsye jam këtu dhe synojmë pjesën e epërme të tabelës. Do ta japim maksimumin dhe besoj se do ta arrijmë objektivin", ka thënë Sokoli

**EPOKA ERE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Trajneri Bylbyl Sokoli është rikthyer pas katër vjetësh në skuadrën e Prishtinës. "Profa" arriti marrëveshje njëvjeçare me drejtuesit e klubit "bardhekaltër" të martën, kurse të mërkurën është prezantuar para futbollistëve kryeqytetas. "FC Prishtina ka zgjedhur kryetrajnerin e ri deri në përfundim të sezonit 2019/20. Bylbyl Sokoli rikthehet pas katër vjetësh në udhëheqje të ekipit", thuhet në njoftimin e Prishtinës. Ndërsa Sokoli ka thënë se klubi që ai do të drejtojë ka futbollistë cilësorë dhe do të luftojnë për kreun e tabelës në elitën e futbollit të

Kosovës. "Prishtina ka skuadër cilësore dhe objektiva të qarta. Për këtë arsye jam këtu dhe synojmë pjesën e epërme të tabelës. Do ta japim maksimumin dhe besojmë se do ta arrijmë objektivin", ka thënë Sokoli.

Strategu i njohur në Kosovë ka qenë trajner i Prishtinës në edicionin 2014/15 duke e drejtuar këtë klub në 25 ndeshje zyrtare (11 fitore, 9 barazime dhe 5 humbje). Ndërsa në kampionatin e kaluar e filloi me drejtimin e Llapit nga e cila skuadër është larguar pas disa xhirove, kurse në sezonin pranveror e mori drejtimin e Ferizajt dhe me një punë të jashtëzakonshme e bëri të pamundurën të mundur dhe ia siguroj kësaj skuadre mbetjen në IPKO Superligë. Sokoli

debuton pikërisht në ndeshjen ndaj ish-skuadrës, Llapit, në ndeshjen që zhvillohet më 14 shtator në stadiumin "Fadil Vokrri". Duhet cekur se Prishtina e shkarkoi trajnerin Mirel Josa pas dy vjetësh si pasojë e mungesës së rezultateve. Trajneri nga Shqipëria me skuadrën ngakryeqyteti i Kosovës arriti të dalë fitues i Kupës në edicionin 2017/18, kurse gjithashtu u shpall edhe dy herë nënkampion i Kosovës, duke mos e fituar titullin në xhiron e fundit. Sivjet në arenën ndërkombëtare Prishtina pati paraqitje të dobët në edicion, sikurse pati paraqitje të dobët edhe në dy ndeshjet e para në këtë kampionat ku njëherë e humbi e në tjetrën luajti baras.

SHKURT

U17-shat fitojnë ndaj Luksemburgut

Përfaqësuesja e Kosovës U17 në futboll ka shënuar fitore në miqësoren e zhvilluar si mysafire e Luksemburgut me rezultat 2-0. Të përzgjedhurit e Besnik Kollarit, të cilët kësaj radhe ishin të gjithë nga vendet evropiane, treguan lojë të mirë në këtë miqësore dhe në fund me meritë iu gëzuan fitores me golat e shënuar nga Justin Gjergji, në minutën e 60 dhe Muharrem Merovci, në minutën e 80.

Dënohet Vushtrria

Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës e ka dënuar skuadrën e Vushtrrisë me 1 000 euro. Ky dënim ka ardhur si pasojë e sjelljeve të gabuara të shikuesve të kësaj saj, të cilët kanë hedhur sende të palejuara në fushën e lojës në ndeshjen e fundjavës ndaj Trepçës '89.

Karateistët kërkojnë pikë olimpike në Tokio

Përfaqësuesja e Kosovës në karate ka udhëtuar drejt Tokios së Japonisë, ku prej 6-8 shtator 2019 do të mbahet Karate 1 Premierë Liga, garë kjo e rëndësishme për pikë olimpike "Tokyo 2020". Kosovën e përfaqësojnë garuesit: Herolind Q. Nishevcu (+84 kg), Alvin F Karaqi (-84 kg), Elhami Shabani (-75 kg) dhe Fortesa Q. Orana (+68 kg), si dhe përzgjedhësi Ylber Sylja. Të gjithë karateistët janë duke ndjekur normën olimpike.

Futbollisti nga Kosova ndërroi jetë pas një aksidenti

Futbollisti Amir Ademi, i cili aktivizohej te FC Kosova Regensburg në Gjermani, ka ndërruar jetë pas një aksidenti të ndodhur mbrëmjen e djeshme. Ademi ka pësuar një aksident automobilistik, me një makinë të tipit "Pasar" dhe ka ndërruar jetë menjëherë. Amiri ishte një nga lojtarët më të mirë të skuadrës ku ai luante, me të cilët ishte pjesë që nga viti 2016. Për shkak të kësaj ngjarje të rëndë të 22-vjeçarit, janë anuluar të gjitha ndeshjet për këtë javë në ligën e ulët gjermane ku bën pjesë FC Kosova Regensburg. Këtë lajm e ka komunikuar vetë klubi ku aktivizohej lojtari, i cili nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka shkruar: "Ngushëllime familjes dhe të gjithë miqve për këtë humbje të madhe! Amiri do të jetë gjithmonë në zemrën tonë", shkruhet në postimin e klubit.

Schick: Duam 6 pikë ndaj Kosovës dhe Malit të Zi

PRAGË, 4 SHTATOR - Patrik Schick beson se Republika Çeke mund t'i fitojë 6 pikë në dy ndeshjet kualifikuese të "Euro 2020" ndaj Kosovës dhe Malit të Zi në shtator,

në mënyrë që t'i shtohen gjasat për ta përforcuar vendin e dytë, i cili siguron kualifikim në Evropian. "Unë jam i fokusuar tërësisht tek ekipi kombëtar dhe në dy ndeshjet

që na presin. Do të vendoset shumëçka, unë jam i gatshëm. Nëse i fitojmë të dyja ndeshjet, do të jemi shumë afër për ta siguruar vendin e dytë. Ne do të përgatite-

mi për ta dhënë më të mirën nga vetja. Ne nuk do ta nënvlerësojmë askënd. Gjashtë pikë nga këto dy ndeshje (ndaj Kosovës e Malit të Zi) janë synimi ynë", ka thënë

Schick. Ndeshja në mes Kosovës dhe Republikës Çeke do të zhvillohet këtë të shtunë në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë duke filluar nga ora 15:00.

Federeri eliminohet nga US Open

NJU YORK, 4 SHTATOR - Roger Federeri është eliminuar mëngjesin e sotëm nga grand slam i US Openit, pas humbjes 3-2 në çerekfinale ndaj bullgarit Grigor

Dimitrov (6-3, 4-6, 6-3, 4-6, 2-6). Edhe pse zvicerani kaloi dy herë në epërsi, duke fituar setin e parë dhe të tretë, dy herë u kap nga Medvedev. Më pas, bullgari

triumfoi në setin final, duke avancuar në gjysmëfinale. Përballë Dimitrov do të jetë rusi Daniil Medvedev, që në çerekfinale mundi zviceranin tjetër

Stanislas Wawrinka me rezultatin 3-1 (7-6, 6-3, 3-6, 6-1). Sfidë e dominuar shumicën e kohës nga rusi që, edhe pse humbi një set, tregoi epërsi në fushë.



Kuqezinjtë sot 'adherojnë' në Francë



TIRANË, 4 SHTATOR - Përfaqësuesja shqiptare mbylli pasditen e së mërkurës seancat stërvitore të grumbullimit në Shqipëri përpara se të nisët për në Francë ku do ta zhvillojë ndeshjen me kampionët e botës më 7 shtator. Në konferencën për shtyp në Durrës, Keidi Bare, mesfushori i Malagës, në kategorinë e dytë të kampionatit spanjoll, shpreh optimizëm për ndeshjen ndaj Francës duke synuar të paktën një barazim. "E prisja shumë këtë ftesë dhe jam shumë i lumtur që ndodhem këtu. Kam folur përpara dy ditësh me trajnerin dhe më tha fjalë shumë të mira. Unë do t'ia justifikoj mendimin e tij të mirë që ka për mua në fushë. Pavarësisht nëse do të luaj unë apo jo, e rëndësishme është të zhvillojmë ndeshje të mirë dhe të marrim rezultat të mirë. Unë kam

rivalitet në repartin tim, por nuk shoh emrat e tjerë, stërvitem për vete dhe jap maksimumin tim. Ky është vetëm fillimi im në Kombëtaren A. Ekipin e shoh shumë të motivuar, por Franca është një ekip shumë i madh dhe ka lojtarë që bëjnë dallimin. Pavarësisht prej mungesave, edhe të tjerët i ka lojtarë shumë të mirë, por kjo nuk duhet të na pengojë që të marrim një rezultat pozitiv. Me një barazim do të jem shumë i kënaqur", shprehet futbollisti i Kombëtares, Keidi Bare.

Për herë të parë në ekipin kombëtar A është grumbulluar edhe Marash Kumbulla, mbrojtësi i Veronës, i cili më parë ka qenë pjesë e ekipit shpresa. "Shpresoj të shkoj më lart sesa tek ekipi i Veronës, edhe pse nuk kam pasur vitin e shkuar shumë hapësira. Sa i përket ftesës që

mora për ekipin A u emocionova shumë pse e dija që do të luaja tek ekipi shpresa U21. Këtu ka lojtarë me shumë përvojë që do të më ndihmojnë edhe mua. Nuk kam pasur ndonjë komunikim special me trajnerin, por ndihem mirë", ka thënë Marash Kumbulla.

Kombëtarja kuqezi do të nisët ditën e enjte në orën 11:00 drejt Francës ku do të zhvillojë atje edhe dy seanca të tjera stërvitore dhe konferencën e fundit për shtyp të trajnerit një ditë përpara takimit. Ndërkaq është përcaktuar edhe ekipi i gjyqtarëve që do ta gjykojë sfidën në mes të Francës dhe kombëtares shqiptare që përbëhet nga gjyqtarë spanjollë. Gjyqtar kryesor është Jesus Gil Manzano, ndërsa anësorë janë Diego Barbero Sevilla dhe Angel Nevado Rodriguez. Gjyqtar i katërt është Jose Maria Sanchez Martinez.

10 lojtarët më të paguar në NBA

HOUSTON, 4 SHTATOR - Në prag të fillimit të sezonit të ri 2019-2020 në NBA, revista "Basketball Insiders" ka publikuar renditjen e lojtarëve më të paguar në NBA. Stephen Curry është në krye të listës, madje ai është basketbollisti i vetëm që kalon shifrën e 40 milionë dollarë për sezon. Në podium janë edhe Chris Paul i Oklahomës (i dyti) e Russell Westbrook i Houston (i treti). Ata pasohen nga Kevin Duranti



NBA: TOP 10 BASKETBOLLISTËT MË TË PAGUAR (2019-2020)

1. Stephen Curry	(Golden State Warriors)	40,231,758 milionerë dollarë
2. Chris Paul	(Oklahoma Thunder)	38,506,482 milionerë dollarë
3. Russell Westbrook	(Houston Rockets)	38,506,482 milionerë dollarë
4. Kevin Durant	(Brooklyn Nets)	38,199,000 milionerë dollarë
5. James Harden	(Houston Rockets)	38,199,000 milionerë dollarë
6. John Wall	(Washington Wizards)	38,199,000 milionerë dollarë
7. LeBron James	(Lakers)	37,436,858 milionerë dollarë
8. Kyle Lowry	(Toronto Raptors)	34,996,296 milionerë dollarë
9. Blake Griffin	(Detroit Pistons)	34,449,964 milionerë dollarë
10. Paul George	(Clippers)	33,005,556 milionerë dollarë

dhe James Hardeni. Vetëm i shtati LeBron James, ikona e NBA-së, që ka zbritur nga froni. Akoma edhe më larg kreut është MVP i finaleve të "play-off"-it, Kawhi Leonard, në vendin e 13-të me 32.7 milionë dollarë.

SHKURT

Chiellini mungon 6 muaj

Juventusit ka konfirmuar se kapiteni Giorgio Chiellini do të jetë jashtë për rreth gjashtë muaj pas një operacioni të suksesshëm të gjurit. Përfaqësuesi italian ka lënduar javën e kaluar gjurin e këmbës së djathtë dhe të martën ishte ndërhyrja kirurgjikale. Nëpërmjet një foto në rrjetin social "Instagram" ai shkruan se operacioni shkoi me sukses. Koha kur ai mund t'i bashkohet skuadrës është në mars të vitit që vjen.

Interi në janar e dëshiron Gotzen

Interi kishte shfaqur interesim për ta transferuar yllin Mario Gotze te Borussia Dortmund. Sipas asaj që shkruan "La Gazzetta dello Sport", zikaltrit kishin shfaqur interesim për sulmuesin gjerman, por asnjëherë nuk kishin nisur një ofertë në drejtim të tij. 27-vjeçarit i skadon kontrata me verdhezinjtë në verën e ardhshme dhe nuk kanë nisur ende kontaktet për rinovimin e saj. Si pasojë e kësaj, drejtuesit e Interit do të përpiqen në merkaton e janarit ta transferojnë atë në "San Siro".

Emre Can zhgënjehet nga Juvetusi

Mesfushori i Juventusit, Emre Can, ka mbetur i tronditur pasi u la jashtë skuadrës së Ligës së Kampionëve te Juventusit nga menaxheri Maurizio Sarri. "Javën e kaluar klubi më premtoi diçka tjetër. Të martën trajneri [jo Sarri] më telefonoi dhe më tha brenda më pak se një minutë që nuk isha në skuadër. Jam i tronditur dhe i zemëruar", ka thënë Can, i cili është bashkuar me Juventusin si transferim i lirë nga Liverpooli në qershor të vitit 2018.

Wilder: Nuk kam respekt për Joshuan

Deontay Wilder pretendon se ai humbi respektin për Anthony Joshuan shumë kohë para humbjes së tij nga Andy Ruiz Jr. Mosmarrëveshja ndaj kampionëve të peshave të rënda lidhet përsëri me bisedat private që ata kishin, ndërsa përpiqeshin të bënin një luftë me njëri-tjetrin në 2017-n dhe 2018-n. Bisedimet për një përplasje të padiskutueshme të titullit të peshave të rënda midis Joshuas dhe Wilderit mbizotëruan titujt e lajmeve të boksit për më shumë se një vit, me fjalë publike të hidhërimit të shkëmbyera nga promotorët dhe menaxherët në media. Sidoqoftë, duket sikur marrëdhënia e luftëtarëve me të vërtetë u prish prapa skenave, pasi të dy boksierët kishin biseda private mes vete. Wilderit tani pretendon se ka humbur respektin për Joshuan, shkaku që ky i fundit ua ka treguar mesazhet promotorëve të vet. "Ne kishim biseda private, por ju shkuat, vrapuat dhe ua treguat mesazhet zotërinjve tuaj. Unë nuk të respektoj më. Nuk kam asnjë respekt për ty. Kur i kryem ato biseda private dhe ju u kthyet pas dhe i treguat Eddit [Hearn] për çfarë po flisnim, atëherë ju humbët respektin tim me gjithë zemër", ka thënë Wilderit.

Owen: Capello shkatërroi karrierën time dhe futbollin anglez

Michael Owen e ka cilësuar Fabio Capellon pleh, ndërsa e ka akuzuar për shkatërrimin e karrierës së tij dhe të futbollit anglez në përgjithësi. Owen shënoi 222 gola me ekipet si Liverpooli, Real Madridi, Newcastle Unitedi dhe Manchester Unitedi, ndërsa shënoi 40 herë në 89 ndeshje për Anglinë. Sidoqoftë, ish-fituesi i "Topit të Artë" luajti vetëm një herë për vendin e tij nën drejtimin e Capellos dhe u tërhoq në moshën 33 vjeç pasi dëmtimet e shtynë. "Pasi erdhi si menaxher i ri, Fabio mendoi se duhej të ndryshonte diçka. Problemi doli të isha unë, Michael Owen. Ai jo vetëm se e shkurtoi një karrierë ndërkombëtare të fituar me vështirësi dhe absolutisht pa asnjë sqarim, por ai gjithashtu vazhdoi të ishte një nga menaxherët më pak efektivë të Anglisë ndonjëherë", ka thënë Owen. "Ai ishte absolutisht një pleh. Sipas mendimit tim, Fabio Capello shkaktoi dëme katastrofike si në karrierën time, po ashtu edhe në futbollin anglez në përgjithësi dhe u pagua mjaft për ta bërë këtë", ka deklaruar Owen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë shpall:

Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

Departamenti: I arsimit parauniversitar
Paga bruto: 423.47 €

Titulli i vendit të punës: Dy zyrtar për tekste shkollore (2 vende pune)

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj

Vendi i punës: Prishtinë **Datë:** 4.09.2019

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton dhe zhvillon planin e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Analizon legjislacionin, politikën dhe procedurat lidhur me zhvillimin e arsimit parauniversitar dhe zhvillimin e planprogrameve dhe teksteve shkollore dhe rekomandon përmirësimet;
- Harton, zhvillon dhe mbikëqyre zbatimin legjislacionit, politikave, standardeve për zhvillimin e arsimit parauniversitar dhe planprogrameve dhe sigurimin e teksteve shkollore;
- Identifikon, dhe ndërlikohet zhvilluesit dhe prodhuesit e teksteve shkollore dhe të materialeve (burimeve) të tjera në harmoni me nevojat e kurrikulit të ri dhe monitoron punën e tyre;
- Këshillon zhvilluesit e materialeve (burimeve) dhe të teksteve shkollore dhe siguron të drejtën e autorit dhe kërkesat e tjera ligjore që janë të mbështetura dhe të mbrojtura me ligj;
- Përgatitë materiale të nevojshme për zhvilluesit e teksteve dhe burimeve dhe ofron materiale relevante për Këshillin e planprogrameve dhe të teksteve shkollore.
- Sigurojnë mbështetje administrative për Këshillin e Kurrikulit lidhur me përgatitjen e teksteve shkollore për arsimin parauniversitar;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimet

- Diploma universitare minimum 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e arsimit;
